UDHËZIM
Nr. 13, datë 29.9.2014

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,"PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR", TË NDRYSHUAR

Mbështeturnë pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1.Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 618,datë 7.9.2006, bëhet 9 900 (nëntëmijë e nëntëqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi ët kufizuar.

2.Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 9 900 (nëntëmijë e nëntëqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10 400 (dhjetëmijë e katërqind) lekë në muaj për kujdestarin.

3.Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2014 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2014, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4.Udhëzimi nr. 6, datë 7.8.2013 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj